



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 14.06.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-134/24, për zyrtarin e lartë z. Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

I. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës (denoncimit) nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

"[...] Sipas raportimeve të mediave, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka deklaruar publikisht se ka qenë i angazhuar si arkitekt për ndërtimet e planifikuara në zonën e Badocit, në një pronë që për aksionarë ka biznesmenët Rr. H. e Sh. K. Para 4 vjetësh Rama publikisht ka deklaruar se është angazhuar nga biznesmeni H. për hartimin e projektit në fjalë dhe janë partner në këtë iniciativë.

Me datë 21.12.2022 në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Prishtinës, me propozim të kryetarit të Prishtinës, z. Përparim Rama, është votuar këmbimi i një pronë komunale me pronën private në pronësi të ish-klientëve të z. Rama, Rr. dhe Sh. K.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik në kuadër të vendimmarrjes hyjnë edhe çastet paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik. Në rastin konkret, vendimi i marrë nga Kuvendi Komunal është bazuar në propozimin e Kryetarit të Komunës. Madje, përmbajtja e vendimit është identike me propozimin. [...]"

Konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia ka njoftuar zyrtarin e lartë, z. Përparim Rama lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (*shkresa zyrtare: APK-DPKI-06/01-158/24*).

Më pas, me qëllim të sqarimit të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj situatë është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në fjalë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia lidhur me këtë rast. Në takim, zyrtari i lartë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e tij lidhur me rastin në fjalë, e gjithashtu të njëjtat ia ka përcjellur në Agjenci edhe në formë të shkruar.

Në deklaratën e dërguar Agjencisë bashkë me dokumentacionin përcjellës nga zyrtari i lartë z. Përparim Ram (*shkresa zyrtare: APK-DPKI-158-1/24*), njëherit subjekt i trajtimit për konflikt të mundshëm të interesit, theksohet se (*citojmë*):

“Referuar shkresës suaj të datës 30.01.2024, me Nr. Prot. 158/24, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, më lejoni që në vijim të jap këtë deklaratë informuese lidhur me çështjen në fjalë.

1. Unë kam qenë i angazhuar në hartimin e projektit arkitekturor për lagjen në kuadër të kompanisë sime 4M Group, me seli në Londër, në vitin 2017. Projekti i është dorëzuar palës më datën 19.06.2017 dhe pagesa e fundit e cila është realizuar për këtë qëllim është bërë më datën 15.07. 2017. (Shih Dokumentin 1);

2. Pala, është pajisur me Kushtet Urbanistike nga Drejtoria e Urbanizmit në vitin 2019, dhe siç jeni në dijeni, Kushtet Urbanistike nuk prodhojnë asnjë efekt juridik, për shkak se ai dokument paraqet kushtet të cilat duhet t'i plotësoje pala për të nisur procedurën e Lejes Ndërtimore. Në këtë rast, pala asnjëherë nuk është pajisur me leje ndërtimore, për shkak të Vendimit të Ministrisë së Ambientit, i datës 21.02.2020, me Nr. Prot. 1621/20, i cili ka anuluar vendimin e Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës. (Shih Dokumentin);

3. Pas vendimit për anulimin e projektit nga ana e Ministrisë së Ambientit, Zyra Ligjore e kësaj Ministrie, në përgjigje ndaj ankesës së palës, në vitin 2020, me shkresën Nr. Prot. 2678/20, ka obliguar organet komunale për shpronësimin e parcelave private, me qëllim të realizimit të interesit publik. (Shih Dokumentin 3);

4. Më datën 19.01.2021, Kryetari i atëhershëm Shpend Ahmeti, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës e Komunës së Prishtinës, që duke u bazuar në vendimin dhe shkresën e lartcekur të Ministrisë së Ambientit, të nisin procedurat e këmbimit të parcelave private me pronë publike, duke arsyetuar mungesën e mjeteve financiare për realizimin e shpronësimit dhe duke u bazuar në mbrojtjen e Liqenit, e në anën tjetër edhe të të drejtave të pronarëve të tokave atje. (Shih dokumentin 4);

5. Më datën 14.06.2021, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me shumicë votash ka miratuar vendimin për këmbimin e atyre pronave. (shih Dokumentin 5);

6. Pas vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, Ministria e Financave ka bërë vlerësimin e parcelave që ishin objekt i atij këmbimi. Si pasojë e atij vlerësimi, një pjesë e parcelave private kanë mbetur jashtë trajtimit, pavarësisht vendimit të Kuvendit Komunal që kishte përfshirë të gjitha pronat private. (Shih Dokumentin 6);

7. Meqenëse procesi i këmbimit kishte mbetur në gjysmë për shkak të vlerësimit të Ministrisë së Financave, pala, më datën, 21.09.2023, ka bërë kërkesë në Drejtorinë e

Pronës, për vazhdimin e procedurës së këmbimit duke u bazuar në të gjitha shkresat, vendimet dhe vlerësimin që u cekën më lart. (shih Dokumentin 7);

8. Pas pranimit të kërkesës së palës, zyrtarët profesionalë të Drejtorisë së Pronës kanë zhvilluar procedurën standarde, dhe të njëjtën e kanë dërguar për verifikim paraprak në Zyrën Ligjore, para se lënda të dërgohej në Komitetin për Politikë e Financa, ku ka marrë miratimin nga anëtarët e KPF për të hyrë në rend të ditës, dhe pastaj është dërguar në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe votim. (Shih Dokumentin 8);

9. Më datën 21.12.2023, me Nr. Vendimi 01-020/04-236518/23, Kuvendi Komunal ka miratuar këmbimin e parcelave private me ato publike, duke u bazuar në kërkesën për vazhdim të procedurës së mbetur në gjysmë nga procesi i parë. (Shih Dokumentin 9)

10. Më datën 09.01.2024, me nr. Prot. 020-1006/4, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka lëshuar Konfirmimin e Ligjshmërisë për Aktin e Kuvendit Komunal, lidhur me vendimin e lartcekur në pikën 9. (Shih Dokumentin 10);

11. Më datën 11.01.2024, me shkresën me Nr. Prot. 13-070/01-195045/23, Drejtoria e Pronës i ka dërguar Aktin Përcjellës Ministrisë së Financave, në bazë të të cilit ka kërkuar vlerësimin e parcelave që kanë qenë objekt këmbimi sipas vendimit të Kuvendit Komunal dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së. (Shih Dokumentin 11);

12. Më datën 25.01.2024, Ministria e Financave ka marrë vendim me Nr. Prot. 09/02-08-1/2024 për pezullim të ekzekutimit të vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës, lidhur me procedurën e vlerësimit të pronave të paluajtshme që ishin objekt i këmbimit. (Shih Dokumentin 12);

13. Më datën 29.01.2024, MAPL, ka marrë vendim me për anulimin e konfirmimit të ligjshmërisë Nr.020-1006/4, i datës 09.01.2024. (Shih Dokumentin 13);

14. Më datën 31.01.2024, MAPL, nëpërmjet shkresës me Nr. 020-1006/14, i ka kërkuar Komunës së Prishtinës rishqyrtimin e aktit të Kuvendit Komunal. (Shih dokumentin 14);

15. Më datën 08.02.2024, në Seancën e Jashtëzakonshme, ka marrë miratuar vendimin për shfuqizimin e vendimit të vetë. (Shih Dokumentin 15)”.
12/2024

Tutje në deklaratën e tij z. Përparim Rama ka shtuar se:

“Duke u bazuar në procesin që e sqarova më lart, mund të kuptoni lehtësisht në asnjë rast nuk ka vendimmarrje nga Kryetari i Kryeqytetit lidhur me çështjen e ngritur nga ana juaj. Kjo mund të vërtetohet lehtësisht edhe në kompetencat ekskluzive që Kuvendi Komunal ka mbi pronën komunale, që burojnë nga Ligji 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunale si dhe Statuti i Komunës së Prishtinës;

Po ashtu, dua të ju vë në dijeni se edhe pikat e rendit të ditës, me kërkesë të Kryesuesit të Kuvendit Komunal, përgatiten dhe dërgohen fillimisht në Zyrën Ligjore nga Drejtoritë përkatëse e pastaj dërgohen në KPF nga Kryesuesi. Anëtarët e KPF-së kanë mandat që me shumicë votash të aprovojnë pikat e ndryshme në rend dite, apo t'i tërheqin ato. Rendi i ditës, i miratuar në mbledhjen e KPF-së, dërgohet në seancën e Kuvendit Komunal, dhe sërish, në nisje të secilës mbledhje, asamblastët me shumicë votash mund të shtojnë apo heqin pika nga rendi i ditës në secilën seancë. (Shihni transkriptet e mbledhjeve të KPF-së

dhe Kuvendit Komunal të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës);

Këtë proces, po e shpjegoj me qëllim që ta keni një pasqyrë të qartë për procedurën që ndiqet në secilin rast e rrethanë në Kuvendin Komunal të Prishtinës;

Me Statut si akti me të lartë juridik të Komunës është e përcaktuar se: "në listën e përgjegjësive të padelegueshme të marra nga LVL-ja, çështjet në vijim mbeten në kompetencë të Kuvendit të Komunës dhe nuk mund të delegohen, janë:

a) Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës,

b) Miratimi i:

- Planit zhvillimor komunal (PZHK),

- Planit zhvillimor urban (PZHU),

- Planit rregullues urban (PRRU), dhe ndryshimi i tyre.

Kështu, marrë parasysh këto fakte, deklaroj se në asnjë rrethanë nuk kam konflikt interesi në këtë procedurë". (përfundim i shkresës së cituar).

Në kompletim të dokumentacionit dhe sqarimit të mëtutjeshëm të rastit në fjalë, Agjencia ka kërkuar dhe mbledhur informacion dhe dokumentacion shtesë nga Komuna e Prishtinës.

Agjencia ka analizuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit për konflikt të mundshëm të interesit dhe raportimet në media 'online' për këtë rast, deklaratat, sqarimet dhe dokumentacionin e dërguar nga z. Përparim Rama sipas kërkesës së Agjencisë, si dhe provat tjera të siguruara sipas detyrës zyrtare, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me datë 06.04.2017, z. Përparim Rama, në kuadër të kompanisë së tij '4M Group', me seli në Londër, është angazhuar në hartimin e projektit arkitekturor për Rr. H., përfaqësues/pronar i biznesit 'Lakeside Gardens' LLC, e ku projekti në fjalë i është dorëzuar atij më datën 19.06.2017, ndërsa pagesa e fundit e cila është realizuar për këtë qëllim është bërë më datën 05.07.2017 (shkresa zyrtare me nr. protokoll: APK-DPKI-06-871/24);

Me datë 20.12.2019, me Vendimin nr. 05NR.350/02-0222986/17, të Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, pronari i biznesit privat Rr. H. është pajisur me Kushtet Urbanistike nga Drejtoria e Urbanizmit, por ende pa u pajisur me leje ndërtimore i njëjti vendim është anuluar me Vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, Nr. ZSP-149/20, të datës 21.02.2020;

Me datë 04.11.2020, përmes shkresës nr. Prot. 2678/20, zyra Ligjore e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, në përgjigje ndaj ankesës së Rr. H. pronar i biznesit në fjalë, ka obliguar organet komunale për shpronësimin e parcelave private;

Më datë 19.01.2021, ish Kryetari i Komunës së Prishtinës (Sh. A.), duke u bazuar në vendimin dhe shkresën e lartcekur të Ministrisë së Ambientit, kishte kërkuar nga Drejtoria e Pronës e Komunës së Prishtinës, që meqenëse, 'në zonat 1, 2 dhe 3 Kuvendi ka vendos moratorium të zbatimit të planeve, Ministria na ka obliguar të procedojmë me shpronësim. Natyrisht në rastin tonë nuk kemi mundësi me shpronësim por do të tentojmë këmbimin. Kështu i zgjidhim disa probleme, duke mbrojtur Badovcin nga ndërtimet dhe në të njëjtën kohë duke mbrojtur të

drejtat e pronarëve. Shpresoj se do të mund ta realizojmë në qoftë se sasia e pronave private nuk është e madhe’;

Me datë 4.06.2021, me Vendimin nr. 01/463/03-112375/21, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me shumicë votash është miratuar propozimin e (ish) Kryetarit të Prishtinës për këmbimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Rr. H. dhe Sh. K., ndërsa, Ministria e Financave (Departamenti i Tatimit në Pronë), ka bërë vlerësimin dhe aprovimin (datë 23.05.2022) e pjeshëm të parcelave private që ishin objekt i atij këmbimi, duke lënë jashtë trajtimit disa sosh, pavarësisht vendimit të Kuvendit Komunal që kishte përfshirë të gjitha pronat private në fjalë;

Me datë 21.09.2023, palët Rr. H. dhe Sh. K, përmes përfaqësueses së tyre të autorizuar kanë parashtruar kërkesë në Drejtorinë e Pronës në Komunën e Prishtinës për vazhdimin e procedurës së kompensimit të pronave sipas vlerësimit të lartcekur, meqë procesi i këmbimit të pronave nuk ishte i plotë për shkak të vlerësimit të pjeshëm nga ana e Ministrisë së Financave;

Më datë 21.11.2023, zyrtarët respektiv të Drejtorisë së Pronës në Komunën e Prishtinës, e kanë dërguar kërkesën në fjalë për verifikim paraprak në Zyrën Ligjore, më pas në Komitetin për Politikë e Financa, dhe pastaj është dërguar në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe votim;

Propozimin e pikës së rendit të ditës nga Drejtoria e Pronës e datës 21.11.2023, propozim-vendimi i përgatitur nga Zyra Ligjore si dhe rendi i ditës për seancën e datës 21.12.2023, të cilat i janë adresuar Kuvendit të Komunës së Prishtinës si akt-propozim i Kryetarit të Prishtinës, nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Prishtinës dhe se e njëjta praktikë ndiqet edhe me të gjitha rastet tjera analoge (*shkresa zyrtare me nr. protokoll: APK-DPKI-06-871/24*);

Më datën 21.12.2023, Kuvendi Komunal në Prishtinë përmes vendimit Nr. 01-020/04-236518/23, miraton propozimin e Kryetarit të Prishtinës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve R.H. dhe SH.K.;

Me datë 09.01.2024, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka lëshuar Konfirmimin e Ligjshmërisë për Aktin e Kuvendit Komunal me nr. Prot. 020-1006/4, lidhur me vendimin Nr. 01-020/04-236518/23, të datës 26.12.2023;

Me datë 11.01.2024, Drejtoria e Pronës në Komunën e Prishtinës, përmes shkresës Nr. Prot. 13-070/01-195045/23, i ka dërguar Aktin Përcjellës Ministrisë së Financave, duke i kërkuar vlerësimin e parcelave që kanë qenë objekt këmbimi sipas vendimit të Kuvendit Komunal dhe konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së;

Me datë 25.01.2024, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka nxjerrë vendimin Nr. Prot. 09/02-08-1/2024, për pezullim të ekzekutimit të vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës Nr. 01-020/04-236518/23, të datës 26.12.2023, lidhur me procedurën e vlerësimit të pronave të paluajtshme që kanë qenë objekt i këmbimit;

Me datë 29.01.2024, MAPL ka nxjerrë Vendim me Nr. Prot.: 020-1006/12, për anulimin e konfirmimit të ligjshmërisë Nr.020-1006/4, të datës 09.01.2024;

Me datë 31.01.2024, MAPL, përmes shkresës Nr. 020-1006/14, i ka kërkuar Kuvendit të Kryeqytetit të Prishtinës të ndërmarr veprime dhe brenda fatit prej 30 ditëve të rishqyrtoj dhe harmonizoj aktin në pajtim me legjislacionin në fuqi;

Kuvendi i Kryeqytetit në mbledhjen e datës 08.02.2024, merr Vendim Nr. 01-035/01-22521/24 për miratimin e vendimit për anulimin e vendimit të vetë Nr. 01-020/04-236518/23, të datës 26.12.2023.

Pas konstatimit të gjendjes faktike si më lartë, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, për zyrtarin e lartë z. Përparim Rama, pasi që propozimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama drejtuar Kuvendit të Komunës së Prishtinës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve R.H. dhe SH.K., nuk përben konflikt të interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Fillimisht, me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që:

"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".

Ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiq nga kjo vendimmarrje."

Lidhur me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përkufizuar se:

"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste",

si dhe me nënparagrafin 1.6 të këtij nenin me të cilin është përkufizuar se:

"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. [...]."

Ndërsa dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Kurse, sa i përket veprimeve të ndaluara të zyrtarit, neni 9, paragrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar se:

“Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit i ndalohen këto veprime:

1.8 të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit”.

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes apo çasteve paraprake të vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit apo të personave të afërm me të në një çështje të caktuar. Për tu konstatuar konflikti i interesit në një çështje të caktuar, duhet të plotësohen kushtet thelbësore (kumulative) të tij, siç është vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes si dhe interesi privat i zyrtarit ose i personave të afërm me zyrtarin.

Agjencia ka trajtuar me kujdes pretendimet e raportuesit të rastit sa i përket çasteve paraprake të vendimmarrjes në çështjen konkrete, dhe në këtë drejtim vlerëson se në kuptim të dispozitës së sipërcituar që definon vendimmarrjen, për të konstatuar konfliktin e interesit duke u mbështetur në çastet paraprake të vendimmarrjes në një rast të caktuar, ato (çaste paraprake) duhet të jenë thelbësore dhe përcaktuese në përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës.

‘Propozimi’ i Kryetarit të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama adresuar Kuvendit të Komunës së Prishtinës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve R.H. dhe SH.K., sikurse është theksuar më lartë tek konstatimi i rrethanave faktike, nuk është nënshkruar (formalizuar) në rastin konkret dhe sipas verifikimeve të Agjencisë rezulton se si praktikë nuk nënshkruhet as në rastet tjera të ngjashme, situatë kjo që përjashton vendimmarrjen apo çastet paraprake të vendimmarrjes në kuptim të dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Gjithsesi, edhe sikur pjesëmarrja e Kryetarit të Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama në procesin e këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme të palëve në procedurën e këmbimit, të prezumohet si çast paraprak i vendimmarrjes, prapëseprapë, nuk mund të konstatohet konflikti i interesit, pasi që njëri nga kushtet e domosdoshme kumulative të konfliktit të interesit, siç është interesi privat i personave në lidhje të mëhershme afariste me zyrtarin, nuk plotësohet në rastin konkret¹.

Kjo për faktin se, nga periudha e përmbushjes së marrëveshjes (projektit arkitekturor) mes z. Përparim Rama (pronar i 4M Group) dhe klientit Rr. H. (pronar i ‘Lakeside Gardens’ LLC), që konsiderohet pagesa e fundit për këtë qëllim e datës 05.07.2017 (shkresa zyrtare me nr. protokoll: APK-DPKI-06-871/24), e deri tek ‘propozimi’ i datës 21.11.2023, i Kryetarit të Prishtinës z. Përparim Rama për këmbimin e pronës së

¹ Një zyrtar mund të pyesë veten se për sa kohë që nga mbarimi i shkollës, ndërprerja e marrëdhënies së punës ose divorci, ish-shokët apo partnerët cilësohen persona të afërm. Si pikë referimi mund të merret periudha kohore prej pesë vitesh. Për pesë vite, zyrtari e ka të ndaluar të ndërmarrë veprime që përshtaten interesit të personave në lidhje të mëhershme biznesi (neni 9, nënparagrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit – derivat i nxjerrë nga Udhëzuesi për Administrimin e Konfliktit të Interesit në Shërbimin Publik, fq.17 - www.coe.int/peck2.

paluajtshme komunale, me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve R.H. dhe SH.K., kanë kaluar më shumë se pesë (5) vjet, prandaj ndalesa në kuptim të dispozitave të sipërcituara (neni 6, lidhur me nenin 9, nënparagrafi 1.8 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nuk mund të zbatohet në rastin konkret.

* * *

Agjencia ka trajtuar gjithashtu edhe kërkesën e njëkohshme të një raportuesi të jashtëm për mundësinë e konfliktit të interesit të Kryetarit të Prishtinës z. Përparim Rama, ku theksohet se (citojmë nga kërkesa e raportuesit):

“[...] Brenda institucionit të Komunës së Prishtinës ka zyre K. R., bashkëshortja e kryetarit z. Përparim Rama. Sinjalizuesit na kanë ofruar dëshmi nga numri dhe adresa elektronike zyrtare e saj me rks-gov.net. Para disa muajve Komuna e Prishtinës ka ndarë 80 mijë euro si mjete financiare nga subvencionet pa thirrje publike për organizatën “The library project - Kosova”, për çka është ngritur si shqetësim në kuvendin komunal për konflikt interesi pasi K.R. angazhohet në këtë projekt për të cilin ka pohuar edhe z. Rama në një paraqitje publike.[...]”

Në takimin e mbajtur me Kryetarin e Prishtinës z. Përparim Rama, e më pas edhe në deklaratën e tij me shkrim (shkresa zyrtare: APK-DPKI-158-2/24) dërguar Agjencisë, i njëjti ka deklaruar se (citojmë):

“Referuar takimit të datës 15.02.2024 për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit të bashkëshortes sime K. R., për shkak të angazhimit të saj në Library Project, më lejoni që në vijim të jap këtë deklaratë informuese lidhur me çështjen në fjalë.

Bashkëshortja ime nuk është e angazhuar në asnjë pozicion brenda kabinetit tim në kapacitetet funksionale apo formale, si dhe në asnjë pozicion pune në Library Project. Në kulturën demokratike perëndimore "Zonja e Parë" (First Lady) zakonisht angazhohet në aktivitete të ndryshme vullnetare dhe promovuese të punës së institucionit të cilin e udhëheqë bashkëshorti, si udhëheqës i kryeqytetit i zgjedhur drejtpërdrejtë nga qytetarët e Prishtinës.

K.R. ka qenë dhe mbetet e angazhuar në promovimin vullnetar të shumë projekteve humanitare duke ofruar mbështetje, lidhje sociale dhe mundësi për të ndarë përvoja dhe interesime të përbashkëta të cilat sjellin vlerë dhe ndihmojnë në zhvillimin shoqëror. Ajo është përfshirë në aktiviteteve bamirëse, kulturore, shëndetësore, të mirëqenës së fëmijëve dhe grave, vetëm në kapacitetin e Zonjës së parë e Kryeqytetit.

Sa i përket emailit zyrtar, i njëjti është hapur në cilësinë e Zonjës së Parë të Kryeqytetit dhe ky email është hapur me kërkesën e shefit të kabinetit (shih: dokumenti 1). Por, duke marr parasysh reagimet dhe pas sqarimeve që kemi marr se nuk mund të ketë email zyrtar pa pasur funksion zyrtar, i njëjti email është mbyllur, po ashtu me kërkesën e shefit të kabinetit (shih: dokumenti 2)”

Agjencia ka trajtuar rastin në fjalë dhe sipas detyrës zyrtare ka bërë verifikimet e nevojshme me institucionet përkatëse, dhe me këtë rast nuk ka gjetur që bashkëshortja e Kryetarit të Prishtinës të ketë ndonjë funksion zyrtar apo të jetë e angazhuar në cilësinë e zyrtares në Komunën e Prishtinës, ndërsa e-mail zyrtar i K.R. i hapur me kërkesë të shefit të kabinetit, është mbyllur me datë 28.02.2024.

Gjithsesi, sikurse u tha më lart, edhe në rastin konkret konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen apo çastet paraprake të vendimmarrjes* nën kushtet e ekzistencës së *interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm me zyrtarin* në një çështje të caktuar, ndërsa, në rastin konkret, është fakt që K.R. është person i afërm me zyrtarin e lartë z. Përparim Rama, por, nuk është gjetur që në kuptim të dispozitave të sipërcituara, z. Përparim Rama në cilësinë e Kryetarit të Prishtinës të ketë qenë pjesë e ndonjë vendimmarrjeje apo çasteve paraprake të vendimmarrjes në raport me personin e afërt tij, në këtë rast.

Prandaj, në rastet kur mungon vendimmarrja apo çastet paraprake të vendimmarrjes nga zyrtari (si kusht i domosdoshëm kumulativ), përjashtohet konflikti i interesit sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

II. Agjencia vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: “*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*”

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

VII BULESHKAI
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit